



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 141 Prot.

Tiranë, më datë 31.05.2024

**VENDIM**  
**Nr. 119, datë 31.05.2024**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 31.05.2024:

**VENDOSI:**

- Miratimin në parim të “Planit të Menaxhimit të Parkut Arkeologjik Bylis-Klos 2024-2029”, me kërkesë të Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor (AICS) me rekomandimet e mëposhtme;
  - Parashikimin në tekstin e Planit, të botimit të gërmimeve arkeologjike të mëhershme;
  - Zhvillimin e një metodologjie të konservimit gjatë zbatimit të Planit të Menaxhimit;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Sokol ISMAILI**



**KRYETAR**  
**Blendi GONXHJA**